

# Informacion i detajuar mbi Qiranë Financiare për Automjete

## Informacion rreth Bankës

### Intesa Sanpaolo Bank Albania

Drejtoria Qendrore: Rr "Ismail Qemali", Nr. 27,  
Kutia postare 8319  
1001 Tirane, Shqipëri  
Tel: +355 4 22 76 000; Fax +355 4 22 48 762  
Website: www.intesasanpaolobank.al

## Karakteristikat dhe rreziqet e "Qirasë Financiare"

### Karakteristikat e "Qirasë Financiare"

Qiraja Financiare për automjete akordohet nga Intesa Sanpaolo Bank Albania që të përdoret nga qiramarrësit (huamarrësit) për blerjen e automjeteve të reja dhe të përdorura.

Automjete do të konsiderohen të gjitha automjetet veturë me një patente drejtimi automjeti, tipi B, të përdorur vetëm për transport individual dhe privat dhe jo për transport publik. Pësia e këtyre automjeteve është maksimalisht deri më 3,500 kg, 8 vende, duke përfshirë vendin e shoferit. Automjetet do të konsiderohen të reja kur pronari i parë pas shitësit të parë është Qiradhënësi (Intesa Sanpaolo Bank Albania).

Qiraja Financiare ofrohet në monedhën vendase në LEK dhe në monedhë të huaj në Euro.

Banka financon blerjen e makinave të reja dhe të përdorura nga konçesionarët dhe tregtarët e makinave.

1. Qiramarrësi duhet të ketë një punë me kohë të plotë: minimalisht 7 muaj punë tek punëdhënësi aktual
2. Të ardhurat nga qiraja: minimalisht 6 muaj
3. DTI (Raporti i borxhit ndaj të ardhurave): ≤ 30%
4. Qiramarrësi duhet të deklarojë të ardhurat: pagën dhe çdo burim tjetër të të ardhurave mujore
5. Bashkë-qiramarrës/Garantues: aplikohet nëse është e nevojshme
6. Sigurim me mbulim Kasko & TPL: Paguhet çdo vit nga Qiramarrësi
7. Limiti i moshës së Qiramarrësit: Minimumi 20 vjeç/ Maksimumi 65 vjeç në datën e maturimit të kontratës së qirasë financiare
8. Parapagimi: Lejohet
9. Disbursimi: Qiraja Financiare do të disbursohet 100% në llogarinë rrjedhëse të tregtarit/konçesionarit të makinave
10. Noterizimi i kontratave: Nevojitet/paguhet nga Qiramarrësi
11. Regjistrimi i kolateralit në Zyrën e Regjistrimit të Barrëve Siguruese: Nëse aplikohet nevojitet/paguhet nga Qiramarrësi
12. Paga e kështit mujor: në datën 4 të çdo muaji.

Kolaterali për automjet të ri/të përdorur:

1. Barrë siguruese mbi automjetin – Nuk aplikohet pasi automjeti kalon në pronësi të Intesa Sanpaolo Bank Albania.
2. Sigurim Kasko & TPL

### Tregu i synuar

Klientela e synuar për këtë produkt janë të gjithë individët me të ardhura të qëndrueshme, 100% të deklaruara dhe kanalizuar nëpërmjet llogarive bankare. Këtë produkt mund ta përfitojnë vetëm rezidentët shqiptarë.

### Opsione të tjera shtesë

Pjesëmarrja e Bankës, afati dhe shuma që akordohet do të jetë e ndryshme për automjete të reja dhe të përdorura:

- Pjesëmarrja: Për financim deri në EUR 35,000 minimum 85% e vlerës për automjet të ri dhe 80% për automjet të përdorur
- Pjesëmarrja: Për financim nga EUR 35,001 deri në EUR 50,000 minimum 80% e vlerës për automjet të ri dhe 75% për automjet të përdorur
- Periudha e Përdorimit: Do të financohen vetëm automjetet e rinj me një afat maksimal 72 muaj si dhe automjetet e përdorur të cilët në përfundim të kontratës nuk rezultojnë më shumë se 84 muaj nga viti i prodhimit."

### Dokumentet e nevojshme

Dokumentet e nevojshme për punonjës

- Kartë identiteti/Pasaportë
- Çertifikatë familjare e freskët (tre muajt e fundit)
- Vërtetim i të ardhurave
- Printim të lëvizjeve të llogarisë në banka të tjera ku kanalizohen të ardhurat
- Formulari i Pëlqimit Paraprak
- Patentë
- Librezë e energjisë/ujit ose fatura e fundit

Dokumentet e nevojshme për individët e vetë-punësuar / Aksioner i kompanive private

- Kartë identiteti/Pasaportë
- Printim të lëvizjeve të llogarisë në banka të tjera ku kanalizohet aktiviteti
- Çertifikatë familjare e freskët (tre muajt e fundit)
- Librezë e energjisë/ujit ose fatura e fundit
- Dokumentet ligjore për aktivitetin (Liçenca, NIPT, Ekstrakti i QKR)
- Foto të aktivitetit
- Formulari i Pëlqimit Paraprak2
- Patentë

### **Shërbime suplementare**

Shërbimi suplementar që ofrohet së bashku me qiranë financiare për automjet është llogaria rrjedhëse e qirasë financiare, e cila do të përdoret për transaksionet e qirasë financiare. Qiramarrësi ka të drejtën për t'u pajisur, me kërkesën e tij dhe pa pagesë, me një kopje të projektkontratës së qirase financiare. Kjo e drejtë nuk do të zbatohet nëse banka, në kohën e kërkesës, nuk është e gatshme të vazhdojë me nënshkrimin e kontratës së qirase financiare me qiramarrësin.

Qiramarrësi ka të drejtë të kërkojë në çdo kohë gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës së qirasë financiare, informacion mbi gjendjen e llogarisë në formën e një plani shlyerje (informacion për shumën që ka shlyer dhe detyrimin e mbetur) dhe Banka do t'ia vendosë këtë informacion në dispozicion pa pagesë .

### **Rreziqet e "Qirasë Financiare"**

Monedha e qirasë financiare do të jetë e njëjtë me monedhën e të ardhurave të qiramarrësit. Nuk ekziston asnjë rrezik në lidhje me ndryshimin dhe luhatjen e kursit të këmbimit. Nëse qiraja financiare është në monedhë të ndryshme nga ajo në të cilën Qiramarrësi gjeneron të ardhura atëherë qiramarrësi ka të drejtën e zëvendësimit të monedhës së kredisë në monedhën që gjeneron të ardhura.

Qiramarrësi ka mundësinë të konvertojë monedhën e kredisë në monedhën në të cilën gjeneron të ardhurat, sipas përcaktimeve në kontratën e qirase financiare.

Qiramarrësi do të njoftohet në rastet kur, si rezultat i ndryshimit të kursit të këmbimit, vlera e kësteve të rregullta të pagesës rritet me më shumë se 20% nga vlera që do të rezultonte, nëse do të aplikohet kursi i këmbimit midis monedhës së kredisë dhe monedhës në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat, në datën e nënshkrimit të kontratës.

Nëse monedha e përcaktuar në kontratën e qirase financiare përkon me monedhën që Qiramarrësi gjeneron të ardhurat, I fundit njofton Bankën me shkrim për çdo ndryshim që lidhet me monedhën e gjenerimit të të ardhurave. Në këtë rast qiramarrësi ka të drejtë të konvertojë tepricën e mbetur të kredisë me monedhën që gjeneron të ardhurat.

Llojet e instrumenteve financiare që banka i ofron konsumatorit për t'u mbrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit dhe kushtet - (nuk është e aplikueshme).

Për të dyja llojet e qirasë financiare në Euro/LEK, ekziston rreziku në lidhje me rregullimin e indeksit të tregut, çdo vit deri në maturimin e qirasë financiare.

### Struktura e çmimit:

Kredi të akorduara në LEK / EUR: norma e ndryshueshme shprehet në përqindje vjetore dhe përbëhet nga indeksi i tregut plus marzhin e bankës për të gjithë kohëzgjatjen e Qirasë Financiare.

### **Mundësia e zëvendësimit të sendit/pasurisë (kolateralit)**

Në rast se kredia garantohet me kolateral, qiramarrësi ka të drejtë të zëvendësojë sendin/pasurinë e dhënë si garanci me kusht që Banka të pranojë garancinë zëvendësuese. Qiramarrësi kupton se banka ka diskrecion të plotë për të pranuar ose jo garancinë zëvendësuese të ofruar duke u bazuar, por pa u kufizuar në kritere si: aftësia ripaguese e Qiramarrësit, mjaftueshmeria/rregullsia e dokumentacionit ligjor të garancisë së re që ofrohet, mjaftueshmeria e mbulimit të garancisë së ofruar në raport me kredinë e mbetur në përputhje me legjislacionin dhe kuadrin nënligjor në fuqi. Në rast se palët do të vendosin përgjatë 'Afatit Kontraktor', që të ndryshojnë Kolateralin që shërben për të garantuar detyrimet e Qiramarrësit të rrjedhura nga kjo Kontratë, atëherë Qiramarrësi do të paguajë çdo kosto që lidhet me zëvendësimin e kolateralit, përfshirë por pa u kufizuar me kostot që lidhen me noterizimin apo regjistrimin e garancisë së re në regjistrat perkatese dhe lirimin e garancisë ekzistuese.

## **Kushtet kryesore ekonomike**

Lista e të gjitha kostove dhe shpenzimeve të produktit

### **Norma e Interesit (NI)**

Norma vjetore e interesit që Huamarrësi është i detyruar të paguajë Bankës aplikohet çdo vit; numri i ditëve /360 (treqind e gjashtëdhjetë) dhe llogaritet për shumën e Qirasë Financiare .

Interesi vjetor përbëhet nga elementët e mëposhtëm:

a) një kuotë e caktuar fikse dhe e pandryshueshme si dhe

b) norma bazë e interesit, e cila është një kuotë e ndryshueshme, e barabartë me normën vjetore të indeksit të EURIBOR-it/ T-BILL-it

### "Norma Minimale e Interesit" (NMI)

NMI do të thotë vlera më e ulët vjetore, nën të cilën 'Norma Vjetore e Interesit' nuk do të llogaritet në asnjë rast, megjithëse si rezultat i ndryshimeve të 'Normës Bazë të Interesit', 'Norma vjetore e interesit' do të rezultojë në një vlerë më të ulët (për shkak të aplikimit të formulës: Norma Bazë e Interesit + Marzhin).

Norma vjetore e interesit do të jetë e barabartë me normë më të lartë vjetore midis Normës së Interesit (NI) dhe Normës Minimale të Interesit (NMI).

### "Norma efektive e interesit" (NEI)

**NEI** – është norma efektive e interesit e cila llogaritet dhe percaktohet nga Banka e Shqipërisë në përputhje me parashikimet e Rregullores 48 date 01.07.2015 "Per kredine konsumatore dhe hipotekare" (e ndryshuar) dhe që në asnjë rast nuk mund të tejkalohet nga Banka. NEI maksimal percaktohet në fund të çdo gjashtëmujori për gjashtëmujorin vijues nga Banka e Shqipërisë dhe botohet në faqen e saj zyrtare të internetit e cila mund të aksesohet nga Qiramarrësi në linkun <https://www.bankofalbania.org/>. Banka nuk do të tejkalojë në asnjë rast normën efektive maksimale të interesit të publikuar nga Banka e Shqipërisë për secilën nga kategoritë e kredisë konsumatore që do të akordohen dhe nënshkruhen në gjashtëmujorin pasardhës, duke konsideruar edhe intervalet e shumave të disbursuara, bazuar në normën efektive maksimale të interesit të gjashtëmujorit të mëparshëm.

Norma Efektive e Interesit (NEI) përbën totalin e kostos së financimit për Qiramarrësin, e shprehur si përqindje vjetore e vlerës së financimit të dhënë; dhe llogaritet bazuar në:

- (i) supozimin që kontrata është e vlefshme për afatin kontraktor dhe palët përmbushin rregullisht detyrimet e tyre, sipas kushteve dhe menyrës së rënë dakord në kontratë;
- (ii) supozimin që përqindja e interesit vjetor dhe shpenzimet e tjera mbeten të pandryshuara (fikse) në lidhje me nivelin fillestar dhe do të mbeten të aplikueshme deri në fund të kontratës së qirase financiare; si dhe në
- (iii) supozimin që shuma e financimit lëvrohet menjëherë dhe në total.
- (iv) supozimin që vlera e financimit tërhiqet me komisionin më të madh dhe me normën më të lartë të interesit të zbatueshme për tërheqjen më të zakonshme të kësaj kontrate kredie;
- (v) supozimin që qiraja do të paguhet me 12 këste të barabarta mujore; si dhe në
- (vi) supozimin që kredia është tërhequr në total dhe për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës.

Për qëllime të llogaritjes së NEI, totali i kostos së qirasë financiare nuk përfshin: shpenzimet që nuk njihen; shpenzimet e pagueshme nga Qiramarrësi për moszbatimin e ndonjë prej detyrimeve të parashikuara në këtë kontratë; kostot e pagueshme nga Qiramarrësi lidhur me këtë kontratë Qiraje Financiare për persona të tjerë dhe çdo shpenzim në përgjithësi të detyruar për regjistrimin dhe garancitë; shpenzimet për siguracionin dhe garancitë jo të detyrueshme; dhe shpenzimet në rast ndryshimi të afateve të pagesave. Norma Efektive e Interesit nuk do të tejkalojë në asnjë rast Normën Efektive maksimale të Interesit.

<b>Qirasë Financiare– Klientë / Qiramarrës standard</b>	<b>NI</b>	<b>NMI</b>
Klientë në LEK	T-Bill 1V + 3.5-6%	6-8.5%
Klientë në EURO	Euribor 1V + 4.5-7%	4.5-7%

## Shuma maksimale e Qirasë Financiare dhe afati

### Karakteristikat

Shuma maksimale	LEK 6,250,000 / EUR 50,000 / Limiti ne <b>LEK</b> ekuivalenti i shumës në EUR
Afati	nga 2 Vite deri në 6 Vjet

### \*Shëmbull ilustrativ për llogaritjen e kështit të Qirasë Financiare

Afati	Norma vjetore nominale e interesit	Shuma e kështit mujor për një principal me vlerë EUR 10,000.00
Për 3 vjet	7%	EUR 308.77
<i>*Nëse klienti do të aplikojë për shumën e Qirasë Financiare prej EUR 10,000.00, për një afat prej 3 vite dhe normë interesi 7% do të paguajë kështin e Qirasë Financiare prej EUR 308.77.</i>		
Shuma totale	11,115.72 EUR	
Vlera e interesit	1,115.72 EUR	
Periudha e faljes për normën e interesit	Nuk aplikohet	
Penaliteti për pagesën e vonuar të kështit Kamatvones	10%	

### Kostot dhe shpenzimet për lidhjen e kontratës dhe menaxhimin e marrëdhënies kontraktore

#### Kostot dhe shpenzimet për lidhjen e kontratës

Aktivitetet paraprake	Nuk aplikohet
Vlerësimi teknik	Nuk aplikohet
Pagesa të tjera:	Noterizimi i kontratave duhet të paguhet nga Qiramarrësi. Shpenzimet për Regjistrimin në Zyrën e Barrëve Siguruese (nëse aplikohet). Mbulim Kasko & TPL** Klienti ka të drejtë të zgjedhë një nga kompanitë e sigurimit të miratuara nga banka."
Komisioni i parapagimit / I shlyerjes së parakohshme Përfundimi i një aplikimi për Qiranë Financiare	"0.5% e shumës së parapaguar nëse periudha e mbetur deri në maturim është më e vogël se 1 vit; 1% e shumës së parapaguar nëse periudha e mbetur është më shumë se 1 vit."

#### Kostot dhe shpenzimet për menaxhimin e marrëdhënies kontraktore

Komisioni i mirëmbajtjes së llogarisë së Qirasë Financiare	Sipas kushteve të punës për Individë
Komisioni i administrimit	1% e çmimit të objektit të qirasë financiare
Kostot e komunikimit:	
Kosto e komunikimeve ligjore shkresore	Falas
Kosto e komunikimeve ligjore online	Falas
Njoftim me shkrim për përfundimin e afatit dhe/ose marrjen e pagesës	Nuk aplikohet
Njoftim elektronik (SMS) për përfundimin e afatit dhe/ose marrjen e pagesës	50 LEK (Opsionale, sipas kërkesës së klientit)
Amendimi i kontratës së Qirasë Financiare	Falas
Lëshimi i konfirmimit bankar	50 LEK (Opsionale, sipas kërkesës së klientit)
Penaliteti për shkelje të kushteve kontraktuale	5% e çmimit të objektit të qirasë financiare
"Vlera e mbetur", çmimi simbolik që Qiramarrësi paguan pas mbarimit të afatit të Kontratës, kur vendos ta blejë Objektin e Qirasë.	EUR 1

### Plani i amortizimit

Lloji i amortizimit	Francez
Lloji i kështit	I
Periodiciteti i pagesës së interesit	qëndrueshëm

## Ripagimi para afatit, ndryshimi i njëanshëm i kushteve kontraktore dhe ankesat

### Ripagimi para afatit

Klienti mund të ripaguj Qiranë Financiare në çdo kohë duke njoftuar Bankën të paktën 15 ditë përpara datës së likuidimit.

### Ndryshimi i njëanshëm i kushteve kontraktore

Çdo ndryshim i kushteve të përcaktuara shprehimisht në Kontratën e Qirasë Financiare do të jetë efektiv pas miratimit me shkrim të palëve. Asnjë ndryshim i kushteve të përcaktuara shprehimisht në kontratën e Qirasë Financiare nuk do të jetë efektiv nëse palët nuk bien dakord me shkrim.

### Ankesat

Ankesat mund të paraqiten në bankë duke përdorur një nga format e mëposhtme:

- Me shkresë dërguar në Bankë me postë;
- Në degë tek "Kutia e ankesave & sugjerimeve" (Ju dëgjojmë 100%);
- Ankesat me shkrim nëpërmjet llogarisë së email-it në adresën zyrtare të website-it të Bankës si më poshtë: [complain@intesasanpaolobank.al](mailto:complain@intesasanpaolobank.al)
- Nëpërmjet qendrës së thirrjeve telefonie Call Center në numrin: 08006000

Afati kohor për përgjigjen nga ana e Bankës është maksimalisht 30 ditë nga data e marrjes së ankesës.

## Fjalori i Termave Kryesore

**EURIBOR**- (Euro Interbank Offered Rate, norma e publikuar në sistemin Thomson Reuters në faqen EURIBOR në orën 13:00 CET. Informacioni për llogaritjen e këtij indeksi ndodhen në website: <http://euribor-ebf.eu>)

**Bono Thesari (T-BILL)** - do të thotë Interesi i Rezultuar nga Ankandi i Fundit i Bonove të Thesarit, të emëtuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Informacionet në lidhje me përlllogaritjen mund të gjenden në faqen: [www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)

**DTI** (raporti i borxhit ndaj të ardhurave) - është një masë e financave personale që krahason pagesën mujore të borxhit të një individi me të ardhurat mujore.